



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 718/ 5 prot.

Datë 24 .03.2026

V E N D I M
Nr. 412 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK me *NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë -Durrës km 10.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier, me adresë: *Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15.*

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik të ndryshuara.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” , me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 05.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr.718/2026 protokollit, dhe protokolluar pranë KPP, datë 05.03.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6393, e operatorit ekonomik “Marketing Distribution ” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumentave të tenderit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën me nr. 2554/12 prot., me datë 17.03.2026, protokolluar me tonën nr. 718/2 prot., me datë 17.03.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

Vendos:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “**MARKETING & DISTRIBUTION SHPK, me NUIS/NIPT J72124001N**, për procedura e prokurimit publik, *procedurë e hapur me mjete elektronike*, me objekt “**Blerje bojra për printera dhe fotokopje**”, me nr. **REF-77633-02-26-2026** me fond limit prej **8,333,333** (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** sipas DST.
2. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fier, më: 11/03/2026

...

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing Distribution ” sh.p.k për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1. 2. Me shkresën me nr. 2554/12 prot., me datë 17.03.2026, protokolluar me tonën nr. 718/2 prot., me datë 17.03.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

Vendos:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “**MARKETING & DISTRIBUTION SHPK, me NUIS/NIPT J72124001N**, për procedura e prokurimit publik, procedurë e hapur me mjete elektronike, me objekt “**Blerje bojra për printera dhe fotokopje**”, me nr. **REF-77633-02-26-2026** me fond limit prej **8,333,333** (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH sipas DST.
2. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fier, më: 11/03/2026

III.1.3. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.5. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës me nr. 2554/12 prot., me datë 17.03.2026, protokolluar me tonën nr. 718/2 prot., me datë 17.03.2026 (shkresë e ardhur dhe në sistemin elektronik) autoriteti kontraktor informon Komisionin e Prokurimit Publik, për trajtimin e ankesës, si dhe ku ka vendosur pranimin pjesërisht të saj si në vijim:

Vendos:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “**MARKETING & DISTRIBUTION SHPK, me NUIS/NIPT J72124001N**, për procedura e prokurimit publik, procedurë e hapur me mjete elektronike , me objekt “**Blerje bojra për printera dhe fotokopje**”, me nr. **REF-77633-02-26-2026** me fond limit prej **8,333,333 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH** sipas DST.
2. Autoriteti Kontraktor të njoftojë subjektin ankimues dhe KPP, duke i komunikuar me shkrim këtë vendim, në përputhje me rregullat e prokurimit dhe Udhëzimet e APP-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fier, më: 11/03/2026

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për pjesën e pranuar të ankesës paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution ” sh.p.k

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Marketing Distribution ” sh.p.k , me arsyen se :

... Në lidhje me artikullin nr. 22 Xerox B400 me partnumber 106R03583 ju informojmë se, nga komunikimet me distributorë dhe prodhues të këtij produkti, ky toner me këtë partnumber nuk prodhohet më, konkretisht sipas fotos me poshte:... Sa më sipër lutemi vendosjen e partnumber të saktë në mënyrë që pranë institucionit Tuaj të paraqitet malli i cili u sherben , Komisioni i prokurimit publik vë re se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 6 “ Formulari i specifikimeve teknike”, ka parashikuar si në vijim specifikimet teknike,

... ISHTE :

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

NR	Emertimi i produktit	Part Number (ose ekuivalente)	Numer faqesh
1	Lexmark MS 312 dn	51F2H0E	5000
2	Drum Lexmark MS312dn	50F0Z00	60000
3	Xerox Versalink B7025/B7030/B7035MFP	106R03396	30000
4	XXR DRUM VERSALINK B7000,	113R00779	80000
5	XXR FUSER VERSALINK B7000/C7000 SERIES (100K)	115R00115	100000
6	Xerox Versalink B7100	006R01819	34300
7	Drum Xerox Versalink B7100	013R00687	80000
8	XXR FUSER VERTSALINK B7100 SERIES(100K)	115R00115	100000
9	Xerox Drum Ëorkcentre 7500SERIES/7800SERIES,ALTALINK C8000 SERIES BLK	013R00662	125000
10	XEROX ËASTE ËORK CENTRE 7525,7530,7535,7545,7556,ALTALINK C8045	008R13061	44000
11	Lexmark Laserjet MB2236 adë multifunksional	B222X00	6000
12	Imaging Unit Lexmark Laserjet MB2236adë multifunksional	B222Z00	12000
13	Kyocera Ecosys FS6525 MFP	TK-475	15000

14	<i>Kyocera Ecosys FS6525MFP Kyocera Maintanance KIT FS-6025MFP/FS-6030MFP/FS-6525MFP/FS-6530MFP (DRUM +DEVELOPER)</i>	<i>MK-475</i>	
15	<i>Kyocera Fuser FS-6025MFP,FS-6030MFP,FS-6530MFP,FS-6525MFP</i>	<i>FK-475</i>	
16	<i>Drum Kyocera Ecosys FS-6525MFP</i>	<i>DK-475</i>	<i>300000</i>
17	<i>Lexmark B2650 Toner</i>	<i>B262U00</i>	<i>15000</i>
18	<i>Lexmark B2650 Imaging Unit</i>	<i>56F0Z00</i>	<i>60000</i>
19	<i>Xerox B225</i>	<i>006R04404</i>	<i>6000</i>
20	<i>Drum Xerox B225</i>	<i>013R00691</i>	<i>12000</i>
21	<i>Drum Xerox Eörk Center 3225</i>	<i>101R00474</i>	<i>10000</i>
22	<i>Xerox B400</i>	<i>106R03583</i>	<i>13900</i>
23	<i>Drum Xerox B400</i>	<i>101R00554</i>	<i>65000</i>
24	<i>Fuser unit Xerox B400</i>	<i>115R00120</i>	
25	<i>Xerox C7100 (sete)</i>	<i>006R01828 006R01829 006R01830 006R01831</i>	<i>Black 31300 Color 3*18500</i>
26	<i>Drum Xerox C7100</i>	<i>013R00657, 013R00658, 013R00659, 013R00660</i>	<i>Black 67000, Color 3*51000</i>
27	<i>XRX FUSER EC 7120/25</i>	<i>008R13088</i>	
28	<i>Samsung ML 2010r</i>	<i>MLT-D119S</i>	<i>1500</i>
29	<i>Samsung M2022</i>	<i>MLT-D111L</i>	<i>1500</i>
30	<i>Canon Ploter ImagePrograf TM-300(sete)</i>	<i>PFI-320</i>	<i>13000</i>
31	<i>Printheads Prograf TM-300</i>	<i>PF-06</i>	
32	<i>Maintanance Kit TM-300(MC-31)</i>	<i>MC-31</i>	
33	<i>Xerox 5021</i>	<i>006R01573</i>	<i>9000</i>
34	<i>Drum Xerox 5021</i>	<i>013R00670</i>	<i>80000</i>
35	<i>HP P1005</i>	<i>CB435A</i>	<i>1600</i>
36	<i>Samsung ML-1665</i>	<i>MLT-D1042S</i>	<i>1500</i>
37	<i>Samsung ML-1640</i>	<i>MLT-D1082S</i>	<i>1500</i>
38	<i>HP Laserjet Pro M402dn</i>	<i>CF226A</i>	<i>2700</i>
39	<i>Boje Xerox 3025</i>	<i>106R02773</i>	<i>1500</i>
40	<i>Boje Hp1100</i>	<i>C4092A</i>	<i>2500</i>
41	<i>Boje Brother DCP-L2600D</i>	<i>TN-2590XL</i>	<i>3000</i>

42	Drum Brother DCP-L2600D	DR-2590	15000
43	Boje Brother 8260 cdë	TN-423B/TN-423C/TN-423M/TN-423Y	6000 Black/ 4000 Color
44	Drum Brother 8260 cdë	DR-421CL	50000
45	Boje Lexmark C2425	C232HK0/ C232HC0/ C232HM0/ C232HY0	3000 Black/ 2300 Color

-Bashkelidhur DST ne SPE gjenden specifikimet teknike te hartuara nga grupi i punes.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat objekt prokurimi do të kolaudohen e merren në dorëzim nga nje komision i posaçëm i ngritur nga AK. Malli duhet të plotësojë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, në të kundërt AK nuk do t'i marrë materialet në dorëzim dhe do të kërkojë zëvendesimin e tyre derisa të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Në çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen furnizimi, transporti i mallit objekt prokurimi, ambalazhimi, risqet dhe përgjegjësitë ndaj të tretëve, si dhe të gjitha detyrimet apo kostot e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar apo praktikat me të mira, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Shenim: Referimet ku në specifikime, preventiv, dokumenta bashkëlidhur DST në SPE mund të jenë përmendur marka / produkte / origjinë, shoqërohen me fjalën “ose ekuivalente”.

Shenim : *Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe preventive mund te jete perdorur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

BEHET:

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

NR	Emertimi i produktit	Part Number (ose ekuivalente)	Numer faqesh
1	Lexmark MS 312 dn	51F2H0E	5000
2	Drum Lexmark MS312dn	50F0Z00	60000

3	Xerox Versalink B7025/B7030/B7035MFP	106R03396	30000
4	XXR DRUM VERSALINK B7000,	113R00779	80000
5	XXR FUSER VERSALINK B7000/C7000 SERIES (100K)	115R00115	100000
6	Xerox Versalink B7100	006R01819	34300
7	Drum Xerox Versalink B7100	013R00687	80000
8	XXR FUSER VERTSALINK B7100 SERIES(100K)	115R00115	100000
9	Xerox Drum Eörkcentre 7500SERIES/7800SERIES,ALTALINK C8000 SERIES BLK	013R00662	125000
10	XEROX EASTE EÖRK CENTRE 7525,7530,7535,7545,7556,ALTALINK C8045	008R13061	44000
11	Lexmark Laserjet MB2236 adë multifunksional	B222X00	6000
12	Imaging Unit Lexmark Laserjet MB2236adë multifunksional	B220Z00	12000
13	Kyocera Ecosys FS6525 MFP	TK-475	15000
14	Kyocera Ecosys FS6525MFP Kyocera Maintanance KIT FS-6025MFP/FS- 6030MFP/FS-6525MFP/FS-6530MFP (DRUM +DEVELOPER)	MK-475	
15	Kyocera Fuser FS-6025MFP,FS-6030MFP,FS- 6530MFP,FS-6525MFP	FK-475	
16	Drum Kyocera Ecosys FS-6525MFP	DK-475	300000
17	Lexmark B2650 Toner	B262U00	15000
18	Lexmark B2650 Imaging Unit	56F0Z00	60000
19	Xerox B225	006R04404	6000
20	Drum Xerox B225	013R00691	12000
21	Drum Xerox Eörk Center 3225	101R00474	10000
22	Xerox B400	106R03583	13900
23	Drum Xerox B400	101R00554	65000
24	Fuser unit Xerox B400	115R00120	
25	Xerox C7100 (sete)	006R01828 006R01829 006R01830 006R01831	Black 31300 Color 3*18500
26	Drum Xerox C7100	013R00657, 013R00658,	Black 67000, Color 3*51000

		013R00659, 013R00660	
27	XRX FUSER EC 7120/25	008R13088	
28	Samsung ML 2010r	MLT-D119S	1500
29	Samsung M2022	MLT-D111L	1500
30	Canon Ploter ImagePrograf TM-300(sete)	PFI-320	13000
31	Printheads Prograf TM-300	PF-06	
32	Maintanance Kit TM-300(MC-31)	MC-31	
33	Xerox 5021	006R01573	9000
34	Drum Xerox 5021	013R00670	80000
35	HP P1005	CB435A	1600
36	Samsung ML-1665	MLT-D1042S	1500
37	Samsung ML-1640	MLT-D1082S	1500
38	HP Laserjet Pro M402dn	CF226A	2700
39	Boje Xerox 3025	106R02773	1500
40	Boje Hp1100	C4092A	2500
41	Boje Brother DCP-L2600D	TN-2590XL	3000
42	Drum Brother DCP-L2600D	DR-2590	15000
43	Boje Brother 8260 cdë	TN-423B/TN-423C/TN-423M/TN-423Y	6000 Black/ 4000 Color
44	Drum Brother 8260 cdë	DR-421CL	50000
45	Boje Lexmark C2425	C232HK0/ C232HC0/ C232HM0/ C232HY0	3000 Black/ 2300 Color

-Bashkelidhur DST ne SPE gjenden specifikimet teknike te hartuara nga grupi i punes.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mallrat objekt prokurimi do të kolaudohen e merren në dorëzim nga nje komision i posaçëm i ngritur nga AK. Malli duhet të plotësojë të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6, në të kundërt AK nuk do t'i marrë materialet në dorëzim dhe do të kërkojë zëvendesimin e tyre derisa të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Në çmimin dhe vlerën e ofertës, përfshihen furnizimi, transporti i mallit objekt prokurimi, ambalazhimi, risqet dhe përgjegjësitë ndaj të tretëve, si dhe të gjitha detyrimet apo kostot e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar apo praktikrat me të mira, deri në dorëzimin e tyre në destinacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Shenim: Referimet ku në specifikime, preventiv, dokumenta bashkëlidhur DST në SPE mund të jenë përmendur marka / produkte / origjinë, shoqërohen me fjalën “ose ekuivalente”.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efëncën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

III.2.3. Ndëkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.2.5. Në neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

III.2.6 Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën*

e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente". 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet 80 ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.7. Lidhur me pretendimin se operatorit ekonomik ankimes me arsyen se :... [Në lidhje me artikullin nr. 22 Xerox B400 me partnumber 106R03583 ju informojmë se, nga komunikimet me distributorë dhe prodhues të këtij produkti, ky toner me këtë partnumber nuk prodhohet më, konkretisht sipas fotos me

poshte:... Sa më sipër lutemi vendosjen e partnumber të saktë në mënyrë që pranë institucionit Tuaj të paraqitet malli i cili u sherben...], Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar procesverbalit “Për specifikimet teknike dhe argumentimin”, të publikuar në SPE vëren se autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri, duke u shprehur si në vijim: **“Specifikimet teknike per mallrat sipas zerave ne tabelen e mesiperme:**

1. Te gjithë mallrat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it (Kodit) përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.

Argumentimi :

- * **Është plotësisht i përputhshëm** me modelin specifik të pajisjes për të cilën kërkohet.
- * **Përbush specifikimet teknike origjinale të prodhuesit**, duke shmangur interpretimet e përgjithshme ose ekuivalencat e paqarta.
- * **Siguron cilësi dhe performancë të qëndrueshme**, duke reduktuar rrezikun e furnizimit me produkte të papërshtatshme që mund të dëmtojnë pajisjet ose të ulin rendimentin.

2. Te gjithë mallrat duhet të jenë origjinale ose ekuivalente, me vullë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura dhe jo të ricikluara.

Argumentimi :

- * Garantimi i cilësisë dhe performancës
- Produktet origjinale ose ekuivalente sipas standardeve të prodhuesit sigurojnë funksionim optimal të pajisjeve (printera, fotokopje, pajisje multifunksionale), cilësi të qëndrueshme printimi dhe rendiment sipas specifikimeve teknike.

” Mbrojtja e pajisjeve nga dëmtimet

Produkte të rimbushura apo të ricikluara shpesh nuk përmbushin standardet teknike të prodhuesit, gjë që mund të shkaktojë defekte, bllokime, rrjedhje toneri, dëmtim të drum-it apo komponentëve të brendshëm, duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe ndërprerjet në punë.

3. Te gjithë mallrat duhet të jenë të pajisura me pullën e sigurisë së prodhuesit, siç aplikohet nga prodhuesi.

Argumentimi:

- * Garantimi i origjinalitetit
- Pulla e sigurisë përbën element verifikues të autenticitetit të produktit dhe dëshmon se malli është prodhuar, paketuar dhe shpërndarë sipas standardeve zyrtare të prodhuesit.

- * Parandalimi i produkteve të falsifikuara
- Në treg ekziston rreziku i furnizimit me produkte të falsifikuara ose të modifikuara. Pulla e sigurisë ndihmon në identifikimin dhe eliminimin e produkteve jo-autentike, duke mbrojtur institucionin nga furnizime të paligjshme ose me cilësi të ulët.

4. Për bojërat Inkjet (Likuide/pigmente) duhet të shprehet data e skadencës së tyre në ambalazhin e produktit, e cila duhet të jetë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit tek autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

- * Garantimi i cilësisë së printimit

Bojërat Inkjet janë produkte me përbërje kimike të ndjeshme ndaj kohës dhe kushteve të ruajtjes. kalimin e afatit, vetitë fiziko-kimike (viskoziteti, pigmentimi, homogjeniteti) mund të ndryshojnë, duke ndikuar negativisht në cilësinë e printimit.

* Parandalimi i dëmtimit të pajisjeve

Bojërat e alërta me skadencën ose të skaduara mund të shkaktojnë bllokim të kokave të printimit (print head), tharje të bojës në kanale apo defekte të tjera teknike, duke rritur kostot e mirëmbajtjes dhe ndërprerjet në punë.

5. Emri i kompanisë prodhuese/marka, duhet të jetë e stampuar dhe e njëjtë në paketim dhe në trupin e tonerave/bojërave, fuser-ave, drum-eve, siç aplikohet nga prodhuesi. Kodi i tyre te jete i pasqyruar në paketim dhe duhet të korrespondojë me kodin e pasqyruar në tiupin e tonerave/bojërave, fuser-ave, drum-eve.

Argumentimi:

* Garantimi i autenticitetit të produktit

Përputhja e markës dhe kodit ndërmjet paketimit dhe trupit të produktit siguron që malli është origjinal ose ekuivalent sipas standardeve të prodhuesit dhe nuk është i manipuluar apo i zëvendësuar.

* Parandalimi i falsifikimeve dhe produkteve të modifikuara.

Mospërputhja e të dhënave midis paketimit dhe produktit përbën indikator të mundshëm të produkteve të falsifikuara, të rimbushura apo të ricikluara. Kjo kërkesë minimizon rrezikun e fumizimeve jo-konforme. Komisioni i prokurimit publik, konstaton se, lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për të modifikuar kërkesën për artikullin nr. 22; *Xerox B400; 106R03583; 13900*, rezulton se nga shqyrtimi i dokumentacionit që disponon Autoriteti Kontraktor në sistemin elektronik, të publikuar në SPE, konkretisht Procesverbal “*Për specifikimet teknike dhe argumentimin*”, Komisioni gjykon se kërkesa për specifikim teknike duhet të argumentohet teknikisht nga autoriteti kontraktor. Për më tepër, Komisioni gjykon autoriteti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht zë për zë artikujt me specifikimet teknike, derisa ka publikuar një procesverbal “*Për specifikimet teknike dhe argumentimin*” KPP gjykon se, shpjegimi narrativ i dhënë nëpërmjet procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike nuk përbën mjaftueshmëri për bindjen se përse janë të domosdoshme specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor konkretisht për artikullin nr . 22; *Xerox B400; 106R03583; 13900* argumentimi i dhënë nga autoriteti kontraktor, në rastin konkret nuk krijon bindjen e aftësis teknike për specifikimin teknik të dhënë. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të rishikojë specifikimin teknik për artikullin nr. 22, duke e argumentuar teknikisht dhe në të kundërt nëse nuk arrin argumentimin duke e justifikuar nevojën e tij, të heqë specifikimin e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e*

rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-77633-02-26-2026, me objekt: “Blerje bojra per printera dhe fotokopje” me fond limit 8,333,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier .
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, dhe vendimit të KSHA si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing Distribution” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

